



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Lipjan shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Metodave të Arsimit (metolog arsimit)
Institucioni	Komuna Lipjan
Nr. i Referencës	RN00009742
Kodi	RPC0003469
Data e njoftimit	12.08.2022
Afati për aplikim	02.09.2022 - 16.09.2022



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- 1.Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave.
2. Analizon legjislacionin, politikat dhe procedurat lidhur me arsimin e mesëm të ulët dhe rekomandon përmirësime me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve cilësorë si dhe zhvillimin dhe realizimin e reformave arsimore.
- 3.Harton dhe zhvillon legjislacionin, politikat, procedurat standarde si dhe përcakton dokumentacionin shkollor për arsimin e mesëm të ulët.
4. Monitoron mbarëvajtjen, dhe zhvillimin e edukimit dhe arsimimit dhe rekomandon përmirësime me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit të mesëm të ulët.
- 5.Mbështet dhe këshillon institucionet arsimore për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve në arsimin e mesëm të ulët.
6. Merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave për nivelin e arsimit të mesëm të ulët si dhe bashkëpunon me divizionin për plan programeve për planifikim dhe zhvillim të programeve për arsimin e mesëm të ulët.
- 7.Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit dhe strategjive për arsimin e mesëm të ulët dhe harton raporte periodike për procesin e zbatimit të tyre.
- 8.Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare- Fakulteti Filologjik , Filozofik dhe Edukim me të paktën

180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.

- Kualifikime të posaçme formale:

- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për

plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike.

- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit.

- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve.

- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës.

- Aftësi për të bërë gjyime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave.

- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.

- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0003239	RN00009502	Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët	Profesional 2	6	Komuna Lipjan	DREJTORATI PËR ARSIM / Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim



- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit.
- Kopjet e dëshmisë së punësimit- vërtetimin e përvojës së punës ,e njëjta duhet të verifikohet edhe me dëshmi shtesë nga Trusti Pensional i Kosovës apo vërtetim relevant nga Administrata Tatimore e Kosovës
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.
- Çertifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

